



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 15 maj 2023  
Nr. Ref.:RK 2174/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI76/22**

Parashtrues

**Admir Salihu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Pml. nr. 50/2022, të 28 tetorit 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përberë nga:

Gresa Caka-Nirnani, kryetare  
Bajrarn Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radornir Laban, gjyqtar  
Rernzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhrni Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Admir Salihu nga fshati Baks, Komuna e Skenderajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Ramë Gashi, avokat në Prishtinë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 50/2022] e 28 shkurtit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PA1nr. 1306/2021] e 15 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [P. nr. 2643/17] e 13 shkurtit 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

## **Objekt i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe parimi i sigurisë juridike.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), sidhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 2 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 maj 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI72/22] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 7 korrik 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi të dorëzonte në Gjykatë autorizimin për përfaqësim për përfaqësuesin e tij. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 19 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim për përfaqësuesin e tij.
9. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 27 dhjetor 2022, Gjykata i kërkoi parashtruesit të dorëzonte në Gjykatë: Aktgjykimin me shenjë P.nr.384/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë të 26 marsit 2021, Aktgjykimin me shenjë P.nr.2805/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal të 16 nëntorit 2021 dhe Aktgjykimin me

shenjën P. nr. 614/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan të 26 nëntorit 2019, si aktgjykime të cilave iu referohet në kërkesën e tij.

11. Më 30 janar 2023, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë aktgjykimet e kërkuara të gjykatave themelore.
12. Më 12 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës gjendet në vuajtje të dënimit me burgim të shqiptuar me Aktgjykimin [P.nr.2643/17]e Gjykatës Themelore, të 13 shtatorit 2021.
14. Më 23 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës ka qenë një nga aktorët e aksidentit të komunikacionit me pasoja fatale.
15. Më 17maj 2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) ngriti Aktakuzën [PP.II.nr.1251/17] kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ai kishte kryer veprën penale “*Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9lidhur me paragrafin 1*”të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
16. Më13 shtator 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr.2643/17] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit me ç’rast kishte kryer veprën penaleRrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 tëKPRK-së, dhe i shqiptoi dënimin me burgim prej 3 (tri) viteve, si dhe dënimin plotësues sipas nenit 62 paragrafët 1 dhe2nënparagrafi2.5 të KPRK-së,Ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e cila do të llogaritet pas vuajtjes së dënimit me burgim.
17. Gjykata Themelore arsyetoi se në veprimet e parashtruesit të kërkesës, “*manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9, lidhur me par. 1 të KPRK-së, sepse [...] u vërtetua se i akuzuari veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, e në kundërshtim me 54 të LSKRRK-së, ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, pasi ka kaluar udhëkryqin, deri sa në semafor ishte e ndezur drita me ngjyrë të verdhë, edhe pse ka bërë frenim emergjent, pasi që në atë moment ishte duke lëvizur me shpejtësi minimale prej 92.73 km/h, në rrugën ku kufizimi i shpejtësisë ishte 60 km/h, me automjetin e tij e ka goditur këmbësoren-të dëmtuarën, tani të ndjerën B. C., e cila kishte kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë, e cila nga goditja kishte vdekur në vend, andaj Gjykata gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, meqë nuk ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij.*”
18. Më30 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [P.nr.2643/17] të13shtatorit 2021 të Gjykatës Themelore për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkëlqeve të ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës së Apelit që të anulojëaktgjykimin e shkallës së parë dhe të kthejë çështjen në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje ose që Aktgjykimin e njëjtë

të ndryshojë sa i përket vendimit mbi sanksionin penal duke shqiptuar një dënim më të butë, adekuat me rrethanat konkrete të shkakut të aksidentit dhe praktikën gjyqësore për raste të ngjashme.

19. Më 15 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.1306/21] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [P.nr.2643/17] e 13 shtatorit të Gjykatës Themelore, për të cilin konstatoi se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe të së drejtës materiale dhe se dënimi i shqiptuar është caktuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.
20. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike në Aktgjykimin e shkallës së parë, Gjykata e Apelit në arsyetimin e Aktgjykimit të saj vlerësoi se, *“Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht nga deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga ana e palëve, si dhe provave materiale e posaçërisht nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit Ing. F. B. të datës 17.04.2017 në përfundim të ekspertizës ka konstatuar se ngasësi i automjetit Fiat Punto para aksidentit ishte duke lëvizur nga drejtimi i Prishtinës në drejtim të Fushë Kosovës dhe se në atë pjesë të rrugës kufizimi i shpejtësisë është 60 km/h ndërsa ngasësi me automjetin Fiat para fillimit të frenimit ka zhvilluar shpejtësi minimale prej 92.73 km/h dhe kishte kaluar deri sa në semafor ndriçonte drita e verdhë dhe sikurse ngasësi të respektonte kufizimin e shpejtësisë prej 60 km/h do të ndalej para kryqëzimit brenda intervalit kohor të verdhë prej 4 sekondash, aksidenti nuk do të shkaktohej dhe se veprimi i kalimit të rrugës jashtë vendkalimit nuk do të ishte kontribut i aksidentit. Pra nga vlerësimi i ekspertizës së komunikacionit gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike se i akuzuari e ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 1 të KPRK-së dhe si pasojë e vozitjes me shpejtësi më shumë se sa është e lejuar ka ardhur edhe deri te shkaktimi i aksidentit me pasoja fatale për tani të ndjerën B. C.”*
21. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e ligjit penal dhe vendimin mbi sanksionin penal në Aktgjykimin e shkallës së parë, Gjykata e Apelit në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, vlerësoi se, *“Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim dhe dënimit plotësues ndaj të akuzuarit A. S. ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe se të njëjtat i ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj edhe Gjykata e Apelit e Kosovës konsideron që në rastin konkret me dënimin e shqiptuar me burgim dhe dënimin plotësues nga ana e gjykatës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht të ndikohet në të akuzuarin që në të ardhmen mos të kryej vepra penale, të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të ndikoj në rritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, andaj edhe i refuzoi si të pabazura pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me këtë bazë ankimore.”*
22. Më 27 janar 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [PA1.nr.1306/21] të Gjykatës së Apelit të 15 dhjetorit 2021, për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit për procedurën penale, shkeljeve të dispozitave të ligjit penal dhe për shkak të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, duke pretenduar



se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe se shkalla e përgjegjësisë së parashtruesit të kërkesës në veprën penale të kryer nuk është caktuar në mënyrë të qartë, se me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës nuk janë marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe se arsyetimet e gjykatave nuk janë adekuate dhe në përputhje me praktikën e deritanishme gjyqësore.

23. Më 28 shkurt 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 50/2022] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, duke vërtetuar në tërësi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.
24. Lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë, se shkalla e përgjegjësisë së parashtruesit të kërkesës në veprën penale të kryer nuk është caktuar në mënyrë të qartë dhe se cilësia e arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është e kënaqshme, Gjykata Supreme arsyetoi se, *“Konstatimi i Gjykatës Supreme lidhur me këtë pretendim është se këtu bëhet fjalë për vërtetimin e gjendjes faktike, ndërsa konform nenit 432 par. 2 të KPPK për këtë bazë ligjore kërkesa nuk mund të ushtrohet. Megjithatë, pasi mos arsyetimi i përmbajtjes së ekspertizës, mos arsyetimi i vlerësimit të provave sipas kërkesës ligjore nga neni 361 par. 2 të KPPK dhe kundërshtimet që kanë mbetur pa vlerësim ligjor, në kërkesë cekën si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, kjo gjykatë ato i vlerësojë por gjeti se nuk janë të bazuara, nga shkaqet në vijim: Gjykata e shkallës së parë jo vetëm se ka dhënë përmbajtjen e provave formale dhe materiale të administruara, por gjerësisht ka arsyetuar shkaqet për sa ka marrë vendim të tillë (faqet 6, 7 dhe 8 të aktgjykimit të shkallës së parë). Në fakt mbrojtja dëshmia e dëshmitarit B. Sh.-bashkudhëtari i të dënuarit, ka dalluar nga provat materiale dhe gjetjet e ekspertizës, vetëm për faktin se në udhëkryq i dënuari ka kaluar në dritën e gjelbër dhe se ka vozitur me shpejtësi prej 60-70 km/h. I dënuari nuk ka dhënë mbrojtje në shqyrtimin gjyqësor dhe gjykata në aktgjykimin nuk e ka cekur mbrojtjen e tij (deklaratë të tillë kanë dhënë gjatë marrjes në pyetje në polici). Megjithatë eksperti, bazuar në provat materiale e sidomos videoinçizim, ka gjetur se ai te semafori, pak para aksidentit, ka kaluar në dritën e verdhë dhe në momentin e aksidentit ka vozitur me shpejtësi prej 92.73 km/h edhe pse shpejtësia ka qenë e kufizuar në 60 km/h. Eksperti nuk e ka anashkaluar kalimin e rrugës nga këmbësorja në vendin ku kalimi ka qenë i ndaluar, por ka konstatuar se drita e verdhë në semafor ka zgjatur 4 sekonda, largësia në mes këmbësorës dhe automjetit në momentin kur ajo ka filluar kalimin e rrugës ka qenë mbi 51 m, këmbësorës i është nevojitur koha prej 2 sekondave për të kaluar këtë pjesë të rrugës dhe ka pasur konkludimi se nuk kishte ardhur deri te kontakti në mes automjetit dhe këmbësorës, në rast se i dënuari kishte vozitur me shpejtësi e cila ka qenë e lejuar ashtu që këmbësorja nuk i ka kontribuar ardhjes së aksidentit. Aktgjykimit të shkallës së parë nuk i mungon arsyetimi i këtyre fakteve qenësore dhe janë dhënë shpjegimet dhe arsyet ligjore për secilën pjesë të aktgjykimit”*.
25. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për mënyrën e matjes së dënimit, Gjykata Supreme arsyetoi se, *“vendimi për dënimin me këtë njet të jashtëzakonshëm juridik mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërli dhej me mungesën ose paqartësitë të arsyeve lidhur me vendimin për dënimin. Në rastin konkret në kërkesë është pretenduar se rrethanat ekzistuese lehtësuese nuk janë vlerësuar në mënyrë adekuate dhe nuk janë vlerësuar edhe shumë rrethana tjera lehtësuese, vlerësimi i të cilave do të arsyetonte shqiptimin e dënimit më të butë. Gjykata Supreme gjeti se lartësia e dënimit, sikurse është fjala për rastin konkret, nuk mund të*

*kundërshtohet me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përderisa nuk janë bërë shkeljet tjera të cekura më lart, sepse kjo është në diskrecion e gjykatës e cila vendimin e ka marr.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, si dhe parimi i sigurisë juridike.
27. Lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës nuk arsyeton se si kanë ndodhur këto shkelje, por vetëm i ndërlihdh ato me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, zbatimin e gabuar të ligjit, si dhe me shkeljen e parimit të sigurisë juridike për shkak të divergjencës së praktikës gjyqësore në rastetë ngjashme.
28. Sa i përket pretendimeve për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se, *“Vërtetimi i gjendjes faktike në rastin e kryerjes së këtyre veprave, zakonisht bëhet duke u bazuar në Ekspertizat e komunikacionit të cilat veçanërisht bëhen për zbardhjen e fakteve për gjykatën, andaj edhe pretendimi i parë i kësaj kërkesë që duhet adresuar është edhe vërtetimi i gjendjes faktike nga instancat gjyqësore, ku të njëjtat në disa raste vetëm se ka përshkruar përmbajtjen e ekspertizës duke e pretenduar se ka bërë vërtetimin e gjendjes faktike, mirëpo ky vërtetim i kësaj gjendje nuk i plotëson standardet minimale që i përcakton neni 370 i Kodit të Procedurës Penale, ku në paragrafin 6, 7 dhe 8, neni i lartcekur në mënyrë shumë të qartë saktëson se çka duhet përmbajtur një arsyetim i Aktgjykimit me rastin e vërtetimit të gjendjes faktike“.*
29. Lidhur me pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit, parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, thekson se me rastin e matjes së dënimit ndaj tij nuk janë marrë parasysht rrethanat lehtësuese dhe se në këtë mënyrë, dënimi për parashtruesine kërkesës është caktuar në mënyrë të gabuar, i cili dënim, sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, duhet të ishte nën minimumin ligjor.
30. Në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike për shkak të divergjencës së praktikës gjyqësore në raste të ngjashme, parashtruesi i kërkesës thekson se, *“gjykata i ka shqiptuar dënim të lartë me praktikën gjyqësore të mbrojturit tim duke mos u bazuar në asnjë rrethanë rënduese dhe me premisën se kinse është realizuar qëllimi i dënimit, ku këtu krijohet linja e kontradiktës ndërmjet arsyetimit dhe dispozitivit të dhënë, ku nga këto arsye, arsyetimi i dhënë në vendimin e shkallës së parë, kurse vërtetuar nga shkalla e dytë, nuk i plotëson standardet e një arsyetimi të plotë ashtu që përcaktohen nga Kodi i Procedurës Penale, më saktësisht neni 370 par. 6, 7 dhe 8.“*
31. Në dritën e pretendimeve për shkeljen e parimit të sigurisë juridike dhe divergjencën e praktikës gjyqësore, parashtruesi i kërkesës thekson disa aktgjykime të gjykatave të rregullta, përkatësisht Aktgjykimin me shenjën P.nr.384/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, të 26 marsit 2021, Aktgjykimin me shenjën P.nr.2805/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, të 16

nëntorit 2021, dhe Aktgjykimin me shenjë P.nr.614/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan, të 26 nëntorit 2019.

32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

- I. TË SHPALLË të pranueshme këtë kërkesë;*
- II. TË SHPALLË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme me shenjë Pml.nr.50/2022, në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet e saj;*
- III. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin e Gjykatës Supreme me shenjë Pml.nr.50/2022;*
- IV. TË URDHËROHET që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të shpallet në Gazetën Zyrtare;*
- V. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë pas publikimit”.*

### **Dispozitat përkatëse kushtetuese**

## **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

### **Neni 7 [Vlerat]**

- 1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, pages, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*
- 2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.*

[...]

### **Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

- 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
- 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*
- 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.*

[...]

**Neni 31**  
**[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik osesigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

[...]

**Neni 54**  
**[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

**Neni 55**  
**[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]**

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.

### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

[...]

35. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”*



36. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 50/2022] e 28 shkurtit 2022 të Gjykatës Supreme; ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka qartësuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë që pretendon se i janë cenuar, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesë në pajtim me afatin ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç përcaktohet në nenin 49 të Ligjit.
37. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:
- (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*
38. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
39. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesi Praktik i GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë i 31 gushtit 2019; pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284; shih gjithashtu rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 27, dhe rastin [KI175/20](#), cituar më lart, paragrafi 38).
40. Në këtë kontekst dhe në vazhdim, përkitazi me vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).

41. Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me aksidentin e komunikacionit në të cilin një nga pjesëmarrësit ishte edhe parashtruesi i kërkesës. Për shkak të dyshimit të bazuar se ka shkaktuar këtë aksident komunikacioni, Prokuroria Themelore ngriti Aktakuzën [PP.II.nr.1251/17] kundër parashtruesit të kërkesës, me të cilën e akuzoi se ka kryer veprën penale “Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1” të KPRK-së. Më pas, Gjykata Themelore e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për shkaktim të aksidentit të komunikacionit dhe e gjykoji me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve. Parashtruesi i kërkesës është ankuar në Gjykatën e Apelit lidhur me dënimin e Gjykatës Themelore dhe ankesa e tij është refuzuar si e pabazuar. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila është refuzuar nga kjo e fundit.
42. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 7 [Vlerat], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
43. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar dhe arsyetuar saktësisht se si kanë ndodhur shkeljet konkrete të neneve të Kushtetutës, por vetëm ngre pretendime se gjykatat e rregullta i kanë shkelur dispozitat ligjore, përkatësisht kanë shkelur disa nene të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK) dhe disanene të KPRK-së, sepse, siç pretendon, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë, përkatësisht se shkalla e përgjegjësisë së parashtruesit të kërkesës nuk është vërtetuar saktësisht përmes ekspertizës dhe se matja e dënimit nuk ka qenë në përputhje me praktikën e deritanishme të gjykatave të rregullta.
44. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhet me, i) vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të aplikueshme nga gjykatat e rregullta, dhe ii) shkeljen e parimit të sigurisë juridike për shkak të divergjencës së praktikës gjyqësore në raste të ngjashme.
- (i) Përkitazi me pretendimet e parashtruesit lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të aplikueshme nga gjykatat e rregullta**
45. Në këtë drejtim, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, rastet e Gjykatës [KI128/18](#), parashtrues *Limak Kosovo International Airport SH.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; [KI62/19](#), parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; [KI110/19](#), parashtrues *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
46. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës



materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI128/18](#), cituar më lart, paragrafi 56; dhe [KI62/19](#), cituar më lart, paragrafi 58).

47. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë vendimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe gjetjet e ekspertizës së ekspertit.
48. Së pari, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 2643/17] të 13 shtatorit 2021, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për shkak se ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënimin me burgim prej 3 (tri) viteve dhe dënimin plotësues sipas nenit 62 paragrafët 1 dhe 2 nënparagrafi 2.5 të KPRK-së, Ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve. Gjykata Themelore në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, ndër të tjera, theksoi se: *“[...] u vërtetua se i akuzuari veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, e në kundërshtim me 54 të LSKRRK-së, ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, pasi ka kaluar udhëkryqin, deri sa në semafor ishte e ndezur drita me ngjyrë të verdhë, edhe pse ka bërë frenim emergjent, pasi që në atë moment ishte duke lëvizur me shpejtësi minimale prej 92.73 km/h, në rrugën ku kufizimi i shpejtësisë ishte 60 km/h, me automjetin e tij e ka goditur këmbësoren-të dëmtuarën, tani të ndjerën B. C., e cila kishte kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë, e cila nga goditja kishte vdekur në vend, andaj Gjykata gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, meqë nuk ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij.”*
49. Po ashtu, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.1306/21] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkallën e përgjegjësisë së të ndjerës B.C. për shkak të tentativës për të kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë, ku, ndër të tjera, theksoi se: *“[...] Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht nga deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga ana e palëve, si dhe provave materiale e posaçërisht nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit Ing. F. B. të datës 17.04.2017 në përfundim të ekspertizës ka konstatuar se ngasësi i automjetit Fiat Punto para aksidentit ishte duke lëvizur nga drejtimi i Prishtinës në drejtim të Fushë Kosovës dhe se në atë pjesë të rrugës kufizimi i shpejtësisë është 60 km/h ndërsa ngasësi me automjetin Fiat para fillimit të frenimit ka zhvilluar shpejtësi minimale prej 92.73 km/h dhe kishte kaluar deri sa në semafor ndriçonte drita e verdhë dhe sikurse ngasësi të respektonte kufizimin e shpejtësisë prej 60 km/h do të ndalej para kryqëzimit brenda intervalit kohor të verdhë prej 4 sekondash, aksidenti nuk do të shkactohej dhe se veprimi i kalimit të rrugës jashtë vendkalimit nuk do të ishte kontribut i aksidentit.”*
50. Në fund, lidhur me pretendimet parashtruesit të kërkesës kishte vendosur edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme përmes



Aktgjykimit [Pml. nr. 280/2021] lidhur me shkallën e përgjegjesisë së aktorëve të aksidentit të komunikacionit dhe deklaratat e dëshmitarëve të mbrojtjes, arsyetoi se: *“Gjykata e shkallës së parë jo vetëm se ka dhënë përmbajtjen e provave formale dhe materiale të administruara, por gjerësisht ka arsyetuar shkaqet për sa ka marrë vendim të tillë (faqet 6, 7 dhe 8 të aktgjykimit të shkallës së parë). Në fakt mbrojtja dëshmia e dëshmitarit B. Sh.-bashkudhëtari i të dënuarit, ka dalluar nga provat materiale dhe gjetjet e ekspertizës, vetëm për faktin se në udhëkryq i dënuari ka kaluar në dritën e gjelbër dhe se ka vozitur me shpejtësi prej 60-70 km/h. I dënuari nuk ka dhënë mbrojtje në shqyrtimin gjyqësor dhe gjykata në aktgjykimin nuk e ka cekur mbrojtjen e tij (deklaratë të tillë kanë dhënë gjatë marrjes në pyetje në polici). Megjithatë eksperti, bazuar në provat materiale e sidomos videoinçizim, ka gjetur se ai te semafori, pak para aksidentit, ka kaluar në dritën e verdhë dhe në momentin e aksidentit ka vozitur me shpejtësi prej 92.73 km/h edhe pse shpejtësia ka qenë e kufizuar në 60 km/h. Eksperti nuk e ka anashkaluar kalimin e rrugës nga këmbësorja në vendin ku kalimi ka qenë i ndaluar, por ka konstatuar se drita e verdhë në semafor ka zgjatur 4 sekonda, largësia në mes këmbësorës dhe automjetit në momentin kur ajo ka filluar kalimin e rrugës ka qenë mbi 51 m, këmbësorës i është nevojitur koha prej 2 sekondave për të kaluar këtë pjesë të rrugës dhe ka pasur konkludimi se nuk kishte ardhur deri te kontakti në mes automjetit dhe këmbësorës, në rast se i dënuari kishte vozitur me shpejtësi e cila ka qenë e lejuar ashtu që këmbësorja nuk i ka kontribuar ardhjes së aksidentit. Aktgjykimit të shkallës së parë nuk i mungon arsyetimi i këtyre fakteve genësore dhe janë dhënë shpjegimet dhe arsyet ligjore për secilën pjesë të aktgjykimit.”*

51. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë arsyetuar në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke përfshirë pretendimin lidhur me gjetjet e ekspertit, dëshmitë e dëshmitarëve dhe mënyrën e matjes së shkallës së përgjegjesisë. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta u kishin dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.
52. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe sa ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij; e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
53. Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të dispozitave ligjore, thekson se gjykatat e rregullta kanë shkelur dispozitat ligjore të KPPK-së dhe KPRK-së, megjithatë ai nuk e mbështet në asnjë mënyrë dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (shih, rastet e Gjykatës [KI64/20](#), parashtrues *Asllan Meka*,

Aktvendim për papranueshmëri, i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe [KI22/19](#), cituar më lart, paragrafi 43).

54. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë (i) pretendime që bien në kategorinë e pretendimeve të “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

**(ii) Përkitazi me pretendimet e parashtruesit lidhur me shkeljen e parimit të sigurisë juridike për shkak të divergjencës së praktikës gjyqësore në raste të ngjashme**

*Parimet e përgjithshme*

54. Përkitazi me parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka rezultuar në katër parime themelore që karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, dhe atë si në vijim: (i) siguria juridike; (ii) nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore; (iii) divergjenca nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNJ-në; dhe (iv) përjashtimi i arbitraritetit të dukshëm.

55. Lidhur me parimin e parë, GJEDNJ është përqendruar në parimin e sigurisë juridike e që në këtë kontekst është e mishëruar në të gjitha nenet e KEDNJ-së dhe përbën një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit (shih rastin e GJEDNJ-së [Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë](#), kërkesa nr. 13279/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56). Ky parim garanton një stabilitet të caktuar në situata ligjore dhe kontribuon në besimin e publikut në gjykata. Vazhdimësia e divergjencës në praktikë gjyqësore mund të krijojë situata të pasigurisë juridike duke rezultuar në ulje të besimit të publikut në sistemin gjyqësor, ndërsa ky besim është qartazi njëri nga komponentët thelbësor të shtetit që bazohet në sundim të ligjit (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [Hayati Celebi dhe të tjerët kundër Turqisë](#), kërkesa nr. 582/05, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 52; dhe [Ferreira Santos Pardal kundër Portugalisë](#), kërkesa nr. 30123/10, Aktgjykim i 30 korrikut 2015, paragrafi 42; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI42/17](#), parashtrues [Kushtrim Ibraj](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2018, paragrafi 33, si dhe rastin e Gjykatës [KI175/20](#), parashtrues [Agjencia Kosovare e Privatizimit](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 16 prillit 2021, paragrafi 55).

56. Lidhur me parimin e dytë, GJEDNJ ka konstatuar se kërkesat e sigurisë juridike dhe të mbrojtjes së besimit legjitim të publikut, megjithatë nuk garantojnë një të drejtë të fituar në konsistencë të praktikës gjyqësore. Zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është, në vetvete, në kundërshtim me administrimin e drejtë të drejtësisë pasi që mos ruajtja e një qasje dinamike dhe evolutive, do të rrezikonte të pengojë reformën ose përmirësimin e vazhdueshëm (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së [Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 58; dhe [Famulia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), kërkesa nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 116; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës [KI42/17](#), parashtrues [Kushtrim Ibraj](#), cituar më lart, paragrafi 34; si dhe rastin e Gjykatës [KI175/20](#), parashtrues [Agjencia Kosovare e Privatizimit](#), cituar më lart, paragrafi 56).

57. Lidhur me parimin e tretë, GJEDNJ ka konstatuar se mundësia e vendimeve kontradiktore gjyqësore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet



në një rrjet të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me autoritet mbi fushën e juridiksionit territorial të tyre. Divergjencat e tilla mund të paraqiten gjithashtu brenda të së njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me KEDNJ-në (shih, rastet e GJEDNJ-së [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 51; [Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë dhe gjashtëdhjetë e tri \(63\) kërkesa tjera](#), kërkesa nr. 34796/09, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafi 34; [Santo Pinto kundër Portugalisë](#), kërkesa nr. 39005/04, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe [Familia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 122; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI42/17](#), parashtrues [Kushtrim Ibraj](#), cituar më lart, paragrafi 35, si dhe rastin e Gjykatës [KI175/20](#), parashtrues [Agjencia Kosovare e Privatizimit](#), cituar më lart, paragrafi 57).

58. Në fund dhe në lidhje me parimin e katërt, GJEDNJ ka theksuar vazhdimisht se, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore (shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së [Adamsons kundër Letonisë](#), kërkesa nr. 3669/03, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 50) dhe se, në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Përveç kësaj, GJEDNJ-ja ka theksuar se nuk mund të konsiderohet të ketë divergjencë në praktikën gjyqësore kur gjendjet faktike të çështjes janë objektivisht të ndryshme (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [Uçar kundër Turqisë](#), kërkesa nr. 52392/99, Vendim i 29 shtatorit 2009). Njëlloj, trajtimi i dy kontesteve në mënyrë të ndryshme nuk mund të konsiderohet se krijon praktikë gjyqësore divergjente kur kjo arsyetohet nga një ndryshim në gjendjet faktike në fjalë (shih, rastet e GJEDNJ-së [Hayati Çelebi dhe të tjerët](#), kërkesa nr. 582/05, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 52; si dhe [Familia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 116).
59. Gjithashtu, Gjykata vëren se qasja e GJEDNJ-së në analizimin e divergjencave në praktikën gjyqësore, ndryshon në varësi të faktit nëse: (i) divergjencat ekzistojnë brenda të njëjtës degë të gjykatave; ose (ii) ndërmjet dy degëve të ndryshme të gjykatave të cilat janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra. Situata e dytë ka të bëjë me sistemet gjyqësore që përbëhen nga më shumë se një degë e sistemit gjyqësor, secila me gjykatën përkatëse e të pavarur supreme e që nuk i nënshtrohet ndonjë hierarkie të përbashkët gjyqësore. Rasti kryesor i GJEDNJ-së lidhur me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencën e praktikës gjyqësore, [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), bie brenda kësaj kategorie. Sidoqoftë, parimet themelore të vendosura përmes këtij rasti, përdoren gjithashtu në vlerësimin e divergjencave që kanë të bëjnë me praktikën gjyqësore edhe në rastet që i përkasin kategorisë së parë, përkatësisht, atyre me një sistem unik gjyqësor, që do të ishte rasti në kontekst të sistemit juridik të Republikës së Kosovës.
60. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara më lart, Gjykata më tej thekson se GJEDNJ-ja përdor tri kriteret themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, si në vijim: (i) nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjencat të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së [Beian kundër Rumanisë](#), kërkesa nr. 30658/05 (nr. 1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37-39; [Familia Greko-Katolike e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafët 116-135; [Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), kërkesa nr. 23530/02, Aktgjykim i 2



korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe *Hayati Celebi dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 52; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës [KI42/17](#), parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 39, si dhe rastin e Gjykatës [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, cituar më lart, paragrafi 60).

61. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rithekson se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht rasteve të pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, parashtruesit e kërkesave duhet t'i paraqesin Gjykatës argumente përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

*Zbatimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

62. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij, me rastin e matjes së dënimit, Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi dhe veproi në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të gjykatave të tjera themelore në Kosovë.
63. Gjykata thekson se ajo vlerëson konsistencën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Themelore vetëm në raport me shkeljet e pretenduara nga parashtruesi i kërkesës. Rrjedhimisht, mungesa e konsistencës në praktikën gjyqësore duhet të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës. Për të konstatuar një shkelje të tillë, dhe për të konstatuar se të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës janë shkelur si rezultat i “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” në praktikën përkatëse gjyqësore, rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës duhet të jenë tërësisht identike me ato raste të cilave iu referohet parashtruesi i kërkesës.
64. Në mbështetje të argumenteve të tij, parashtruesi i kërkesës ia bashkëngjiti kërkesës Aktgjykimin me shenjën P.nr.559/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë të 26 tetorit 2020, Aktgjykimin me shenjën P.nr.384/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë të 26 marsit 2021, Aktgjykimin me shenjën P.nr.2805/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal të 16 nëntorit 2021 si dhe Aktgjykimin me shenjën P.nr.614/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan të 26 nëntorit 2019, duke pretenduar se në këto raste gjykatat themelore kanë shqiptuar dënime më të buta me burgim për veprat penale të kryera.
65. Duke iu referuar vendimeve të lartcekura, Gjykata vëren se:
- Përmes Aktgjykimit [P. nr. 559/2019] të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë të 26 tetorit 2020 i është shqiptuar dënimi me burgim një personi për një kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit me pasoja fatale, përkatësisht për goditjen e këmbësorit në rrugë magjistrale dhe atë në një pjesë të rrugës ku nuk ka vendkalim të shënuar për këmbësorë. me të cilin ka kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së;

- Përmes Aktgjykimit [P. nr. 384/19] të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë të 26 marsit 2021, për shkak të kryerjes së veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 i KPRK-së, përkatësisht për shkak të sulmit fizik ndaj personit tjetër i është shqiptuar dënimi me kusht një personi, përkatësisht dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, dënim i cili nuk do të zbatohet nëse i akuzuari nuk kryen veprën të re penale brenda një (1) viti, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.;

- Përmes Aktgjykimit [P. nr. 2805/19] të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal të 16 nëntorit 2021, i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti një personi për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit, përkatësisht veprës penale të Rrezikimit të trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së në të cilin personat kanë pësuar lëndime të lehta dhe të rënda trupore, ndërsa një person ka humbur jetën, në të cilin aksident për fajin e të dënuarit janë përplasur një autobus dhe një automjet;

- Përmes Aktgjykimit [P. nr. 614/19] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan të 26 nëntorit 2019 i është shqiptuar dënimi me burgim një personi në kohëzgjatje prej një (1) viti për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit me pasoja fatale, në të cilin aksident për fajin e të dënuarit janë përplasur dy automjete, me të cilin ka kryer veprën penale të Rrezikimit të trafikut publik nga neni 370 paragrafi 9 në lidhje me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të KPRK-së .

66. Bazuar në referencat e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesë nuk arriti të argumentojë se *“dallimet e thella dhe afatgjata”* në praktikën gjyqësore të gjykatave themelore, përveç rrethanave juridike janë tërësisht identike edhe për nga rrethanat faktike me rastet e caktuara të cilave iu është referuar. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se nuk mund të ndërtohet një pretendim për moskonsistencë në vendimmarrje vetëm mbi bazën e ngjashmërive të rastit për nga rrethanat faktike.
67. Përveç kësaj, në dritën e rrethanave të rastit konkret, Gjykata gjeti se nuk u vërtetua as ekzistenca e ngjashmërive të rrethanave faktike të rastit konkret me rastet të cilave iu është referuar parashtruesi i kërkesës. Ndër të tjera, Gjykata vërejti se edhe mes vetë rasteve të referuara nuk ka ngjashmëri për nga rrethanat faktike të rastit.
68. Andaj, Gjykata konsideron se pretendimi (ii) i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar mjaftueshëm dhe në mënyrë bindëse pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak të moskonsistencës së praktikës gjyqësore, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

#### **Përfundim**

69. Si përmbledhje, Gjykata duke u mbështetur në standardet e vendosura në praktikën e saj gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar dhe mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.

70. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (i) pretendime të "shkallës së katërt" dhe kategorinë (ii) pretendime me "mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes". Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.


### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 12 prill 2023, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Safet Hoxha

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka-Nimani

